



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, 16.08.2012

Për: Nexhat Demaku, Kryetar i Komunës së Glllogocit
Naim Bazaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës

Lënda: Shkrese përcjellëse

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, bazuar në kompetencat e Ministrisë së Financave të përcaktuara me Rregulloren 02/2011 për Fushat e Përgjëgjësisë së Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, përkatësisht Ligjit për Partneritet Publiko Privat ka kërkuar nga Departamenti Qendror për Partneritet Publiko-Privat që funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave, të vlerësojë se a janë në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm, vendimi dhe dokumentet tjera të Kuvendit të Komunës së Glllogocit, lidhur me, dhënien me koncesion për partneritet publiko privat të stacionit të autobusëve të kësaj komune.

Bashkangjitur gjeni shkresën e Ministrisë së Financave nr. 1903 date 15.08.2012.

Me respekt,

Agron Maxhuni,
Drejtor i Departamentit Ligjor

Kopje: Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së;
Arkivit të MAPL-së

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
 Ministry of Finance
 Arkiva - Arhiva - Archive

Misioni Org. / Org. Jedin. / Org. Unit: PPP
 Nr. Prot. / Prot. No.: 1903

Nr. i faqëve / Broj stranica / No. pages: 11
 Data / Datum / Date: 15.08.2012

Dafila: PRISHTINE/A



HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
 REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
 QEVERIA E KOSOVES / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
 Ministry of Local Government Administration

Data / Datum / Date: 16.08.2012

Njësia organizative	Nr. i Lëndës	Shtojca	Vlera
-D-	0001-626		

Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave
 Ministarstvo za Finansije / Ministry of Finance

Departamenti Qendror për PPP
 Centralni Departman za JPP
 Central PPP Department

PËR/ZA/TO	Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm - MAPL
NGA/OD/FROM	Lorik Fejzullahu, Udhëheqës i Departamentit Qendror për PPP
CC	Naim Baftiu, Sekretar i Përgjithshëm - MF
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Rreth kërkesës së Kuvendit Komunal të Drenasit për interpretim ligjor
DATA/DATUM/DATE	15 Gusht 2012

I nderuar z. Osmani,

Me kërkesë të z. Agron Maxhuni nga MAPL, ju përcjellim shkresën me përmbajtje të njejtë si në emailin e dërguar më herët.

Në përgjigjen tuaj të datës 24.07.2012 drejtuar Kuvendit Komunal të Drenasit thuhet se vendimi i këtij të fundit dhe vendimet e tjera përkatëse "nuk kanë efekte juridike pasi që janë bazuar në ligjin nr. 03/L-090 për PPP dhe Koncesionet, ndërkohë që ky ligj është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit të ri për PPP nr. 04/L-045 me datë 11 Nëntor 2011"

Megjithatë, neni 52.1 i Ligjit nr. 04/L-045 thotë se dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me procedurat e prokurimit dhe autorizimeve paraprake nga KPPP nuk vlejnë për procedurat e tenderimit kur:

- 1.1 ofertuesit potencial tashme jane parakualifikuar ne pajtim me procedurat e caktuara ne Ligjin e Prokurimit Publik ose ne udhezimet e prokurimit te caktuara nga ndonje institucion nderkombetar financiar; ose
- 1.2 nje kerkese zyrtare per dokumentet e propozimeve eshte publikuar ne pajtim me ligjin ne fuqi.

Sipas informatava që na janë dhënë ne nga Komuna e Drenasit, procedurat e tenderimit kanë filluar dhe përfunduar para se ligji i ri për PPP të hynte në fuqi, përkatësisht në datat e mëposhtme:

10.05.2011 Drejtoria për Planifikim, urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit përmes kërkesës me shkrim kërkoi nga zyra e prokurimit që të fillohej me procedurat e prokurimit për dhënien me koncesion të stacionit të autobusëve, për ndërtim, rehabilitim, operim dhe bartje sipas Ligjit nr. 03/L-090.

11.05.2011 Komuna e Drenasit publikoi 'Njoftimin për shprehje interesi me procedurë trifazëshe' nga ku rezultuan 4 kompani të interesuara.

08.07.2011 Njoftimi për tenderuesit për shprehje interesi ku kaluan fazën e parë ato 4 kompanitë.

01.08.2011 Njoftimi për shprehje interesi në fazën e dytë pas kualifikuese.

19.10.2011 Njoftimi për tenderuesit 'Shprehje interesi' ku sipas renditjes në bazë të pikëve nga komisioni rezultoi si fitues Operatori Ekonomik "Vilezërit Thaqi".

Në bazë të datave të mësipërme të ofruar nga zyrtarët e Komunës së Drenasit, Autoriteti Kontraktues veçse ka përzgjedhur ofertuesin në muajin tetor, pak javë para se të hynte ligji i ri në fuqi. Për rrjedhojë, në bazë të nenit 54 të ligjit për PPP, projekti i Komunës së Drenasit mbetet me ligjin e vjetër për PPP.

Me respekt,



Lorik Fejzullahu
Udhëheqës i Departamentit Qendror për PPP



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS



Nr. 344-8473 dt. 11.06.2012

Në vështrim të nenit 11,12 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 2 paragrafi 1 në paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-090 mbi Partneritetet Publiko Privat dhe Koncesionet në Infrastruktura dhe Procedurat për Dhënien e Tyre, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit dhe Propozimit të Komisionit për shqyrtimin e tenderit për dhënien e së Drejtës për Stacionin e Autobusëve në Drenas dhe objekteve përcjellëse sipas modelit PPP-së, Kuvendit të Komunës së Drenasit në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur me 08.06.2012 mori këto:

V E N D I M

I. Stacioni i Autobusëve me Objektet përcjellëse në Drenas si e drejtë e veçant dhe pronë komunale i UETI me Koncesion Partnerit Privat N.T.SH "Vëllëzori Thaqi" me selinë Vukovc, Komuna e Drenasit sipas kushteve të parapara me Vendimin nr.2369 të datës 15.03.2011 të Kuvendit të Komunës së Drenasit e atë që kolegjialtje prej 40 vitesh, në vështrim të nenit 8 par.1 të Ligjit nr.03/L-090.

II. Përzgjedhja e Partnerit Privat është kryer në pajtuesmëri me dispozitat e nenit 12 deri në nenin 44 të Ligjit mbi Partneritetin Publiko Privat dhe Koncesionet dhe Procedurat e Dhënies së tyre.

III. Raportet përkatësisht obligimet reciproke në mes Autoritetit Kontraktues dhe Partnerit Privat lidhur me dhënien me koncesion Stacionin e autobusëve me objektet përcjellëse do të rregullohen me Marrëveshjen në vështrim të nenit 46 të Ligjit nr.03/L-090.

IV. Me këtë Vendim Autorizohen Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit që në emër të Autoritetit Kontraktues të nënshtrojnë Marrëveshjen (Kontratën) mbi dhënien me koncesion Stacionin e Autobusëve dhe objekteve përcjellëse në Drenas me Partnerin Privat sipas pikës një të këtij Vendim në vështrim të nenit 26 të Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.


V. Aprovimi formal i bazës juridike të këtij raporti juridiko detyrimor nga KDNM-PPP nuk është marrë nga baza së detyrimit kontingente janë më vlerë me të ulët së 5% të buxhetit vjetor të Autoritetit kontraktues në veshtrim të nenit 19.5 të Ligjit nr.03/L-099.

VI. Pjesë përberëse e këtij Vendimi janë edhe: Vendimi i Kuvendit Komunal nr.2369 i datës 15.03.2011, Njoftimi nr.507/3 i datës 24.03.2012 i Ministrisë së Financave – Departamenti i PPP, Shprehja e Interesit dhe Raporti i Komisionit 01 Nr.344-17145 i datës 29.11.2011.

VII. Zbatimin e këtij Vendimi e kanë Drejtorati për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit.

VIII. Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Drenasit.

KUVENDI I KOMUNËS SË DRENASIT



KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Bazaj
/ Naim Bazaj /